

Mn. 1205/4 prot
dt. 31.10.2016

03-347 1.15
25.10.2016



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
SHËRBIMI PËR ÇËSHTJET E
BRENDSHME DHE ANKESAT



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME/
MINISTARSTVO UNUTRAŠNJIH POSLOVA
INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS/
POLICIJSKI INSPEKTORAT KOSOVA

Raporti i Përbashkët Inspektimi

**VLERËSIMI I EFIKASITETIT NË ZBATIMIN E MEMORANDUMIT TË
BASHKËPUNIMIT PËR ORGANIZIMIN E SHËRBIMEVE TË
PËRBASHKËTA TË POLICIMIT TË POLICISË SË KOSOVËS DHE
POLICISË SË SHTETIT SHQIPTAR NË TERRITORIN E REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË GJATË SEZONES SË VERËS**

Kosovë-Shqipëri



GUSHT 2016

ARBEN SKENDO
Drejtor i SHCBA-së



HILMI MEHMETI
Kryeshef Ekzekutiv i IPK-së



SHKURTESAT

RK	Republika e Kosovës
RSH	Republika e Shqipërisë
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
PK	Policia e Kosovës
PSH	Policia e Shtetit
DPP	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë
DPSH	Drejtoria e Policisë së Shtetit
IPK	Inspektorati Policor i Kosovës
SHÇBA	Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat
DI	Departamenti i Inspektimeve
DIA	Drejtoria e Inspektimit dhe Ankesave
NJKA	Njësia e Kontrollit të Autostradës
NJRKRR	Njësia Rajonale e Komunikacionit Rrugor

PËRMBAJTJA

1. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE.....(4-5)
2. HYRJA.....(6-7)
3. PERMBAJTJA.....(8-19)
 - 3.1 Vlerësimi i detyrave për respektimin e memorandumit të bashkepunimit
 - 3.2 Vlerësimi i performances policore dhe rezultatet e patrullimeve të përbashkëta
 - 3.3 Vlerësimi i të priturve të qytetarëve të cilët qarkullojnë përgjatë “Rrugës së Kombit”
4. PËRFUNDIMET.....(13-14)
5. REKOMANDIMET.....(14)

1. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

1.1 Njësitë e Inspektimit të të dy vendeve, Departamenti i Inspektimit në kuadër të IPK-së dhe Drejtoria e Inspektimit dhe Ankesave në kuadër të SHQBA-së kanë zhvilluar Inspektim të jashtëzakonshëm/të pa planifikuar nga me temën **“Vlerësimi i efikasitetit në zbatimin e memorandumit të bashkëpunimit për organizimin e shërbimeve të përbashkëta të policimit rrugor të Policisë së Kosovës dhe Policisë së Shtetit Shqiptar në territorin e Republikës së Shqipërisë gjatë sezonës së verës”**. Ky inspektim është shtrirë në strukturat përkatëse policore të të dy vendeve konkretisht në Divizionin e Komunikacionit Rrugorë në Republikën e Kosovës dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Qarkullimit Rrugorë në Republikën e Shqipërisë,

1.2 Me hyrjen në fuqi të “Memorandumit të bashkëpunimit për organizimin e shërbimeve të përbashkëta të policimit rrugor të Policisë së Kosovës dhe Policisë së Shtetit Shqiptar në territorin e Republikës së Shqipërisë gjatë sezonës së verës”, të dy drejtoritë si Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës dhe Drejtoria e Policisë së Shtetit, kanë ndermarrë veprimet konkrete përgaditore planifikuese lidhur me zbatimin e marrëveshjes në mes të dyja vendeve. Të dy drejtoritë e përgjithshme të policisë së të dyja vendeve kanë hartur urdhërat operativ që përcaktojnë dhe konkretizojnë veprimet operacionale drejt qëllimit të zbatimit të këtij memorandumi.

1.3 Për të funksionalizuar këtë memorandumin e bashkëpunimit, nga Njësitë Regjionale të Komunikacionit Rrugor dhe Njësia për Kontrollin e Autostradës (Policia e Kosovës) janë parashikuar një numër prej 6 (gjashtë) punonjësish dhe 3 (tre) automjete, të cilët bashkë me Njësitë e Policisë Rrugore (Policia Shqiptare) do të angazhohen për kryerjen e patrullimeve të përbashkëta nëpër aksët rrugore të planifikuara sipas memorandumit të bashkëpunimit.

1.4 Patrullat e përbashkëta të të dy policive në përputhje me marrëveshjen e bashkëpunimit aplikojnë kontrole dhe vëzhgim të mbarëvajtjes së qarkullimit rrugor duke qëndruar nëpër pika statike, në vende këto të identifikuar si **“njolla të zeza”**. Orari i angazhimit të njësive policore të patrullave të përbashkëta aplikohet në dy turne/ndërrime. Turni/ndërrimi paradite aplikohet nga ora 06⁰⁰ të mëngjesit - deri në ora 14⁰⁰ për 5 ditë (e hënë- e enjte dhe të shtunën). Ndërsa turni/ndërrimi i dytë aplikohet nga ora 14⁰⁰-22⁰⁰ gjatë të premtave dhe të dielave për shkak të fluksit të largimit të udhëtarëve nga Republika e Shqipërisë në drejtim të Kosovës.

1.5 Zyrtarët policorë të njësive policore nga Kosova, gjatë shërbimit në Republikën e Shqipërisë akomodohen në qytetin e Durrësit, në Shtepinë e Pushimeve të Ministrisë së Brendshme të Shqipërisë. Për zyrtarët policorë të cilët janë të planzuar në Qarkun/Regjionin e Lezhës përben një distancë rreth 100 km rrugë të cilën e kalojnë nga Durrësi në Lezhë dhe anasjelltas.

1.6 Njësitë policore të patrullimeve të përbashkët nuk janë të pajisura me radar për matjen e shpejtësisë së lëvizjes së automjeteve dhe alkoteste matjen e prezencës së alkolit në organizmëm. Njësitë policore shqiptare kanë mungesë të theksuar të këtyre pajisjeve, ndërsa në anën tjetër, njësitë policore të PK-së kanë ardhur të pa pajisura me këto pajisje pasi nuk janë të kalibruara nga institucioni përgjegjës i Republikës së Shqipërisë dhe pa një proces të tillë, organi administrative shtetëror ose Gjykata Administrative në Shqipëri nuk i njeh fuqin e provës gjatë procedimit administrativ dhe gjyqësor.

1.7 Në përfundim të qëndrimit 10 ditor në territorin e Republikës së Shqipërisë nga ana e njesisë policore të PK-së, përpilohet një raport i shkurtër, i cili i dërgohet nëpërmes zingjirit të komunikimit Drejtorit për Preventiv në Komunikacionin Rrugor në Drejtori të Përgjithshme të PK-së, i cili në përfundim të sezonit përgatitë raportin përmbledhës për ecurinë e bashkëpunimit si dhe një analizë pasoperacionale. Në anën tjetër, Sektorët e Qarkullimit Rrugorë në Drejtoritë Vendore Durrës dhe Lezhë nuk kishin hartuar apo administruar raporte përmbledhëse për aktivitete dhe rezultatet mbi ecurinë e njësive të patrullimeve të përbashkëta të cilat funksionojnë gjatë 10 ditëve.

1.8 Qytetarët (responentet) e intervistuar nga ekipi i inspektimit, kanë opinion pozitiv lidhur me organizimin e patrullimit të përbashkët të policive të të dyja vendeve dhe e kanë mirëpritur një veprim të tillë. Ata u shprehën se janë të kënaqur dhe e përkrahin prezencën e njësive policore të përbashkëta të dy vendeve nëpër akset rrugore ku ka një fluks të lartë, me qytetar kosovar të cilët hynë në territorin e Shqipërisë dhe anasjelltas.

2. HYRJJE

2.1. Në bazë të Memorandumit të Bashkëpunimit, mes MPB-së, së Republikës së Kosovës dhe MPB-së së Republikës së Shqipërisë “*Mbi forcimin e bashkëpunimit të Kontrollit të Brendshëm*” Tiranë, 23.03.2015, të Ligjit të Inspektoratit Policor të Kosovës Nr. 03/L-231, neni 24 pika 1, 2, Ligjit të Shërbimit për Çështje të Brendshme dhe Ankesa të Shqipërisë Nr. 70/2014, neni 61, pika 1 dhe neni 64 pika 1 si dhe në përputhje me Planin e Veprimit të miratuar ndërmjet Kryeshefit Ekzekutiv të IPK-së dhe Drejtorit të Përgjithshëm të SHÇBA-së, njësitë e Inspektimit të të dy vendeve kanë zhvilluar Inspektim të jashtëzakonshëm/të pa planifikuar nga data 08.08.2016 deri me 12.08.2016.

2.2 Ky inspektim është bërë në strukturat përkatëse policore të të dy vendeve konkretisht në Divizionin e Komunikacionit Rrugorë në Republikën e Kosovës dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Qarkullimit Rrugorë në Republikën e Shqipërisë, me temën “**Vlerësimi i efikasitetit në zbatimin e memorandumit të bashkëpunimit për organizimin e shërbimeve të përbashkëta të policimit rrugor të Policisë së Kosovës dhe Policisë së Shtetit Shqiptar në territorin e Republikës së Shqipërisë gjatë sezonës së verës**”.

2.3 Qëllimi i këtij inspektimi ka qenë vlerësimi, dhe respektimi i detyrimeve që rrjedhin nga respektimi i Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet Policisë së Kosovës dhe Policisë së Shtetit të datës 30.06.2016 “Për organizimin e shërbimeve të përbashkëta të policimit rrugor të Policisë së Kosovës dhe Policisë së Shtetit Shqiptar në territorin e Republikës së Shqipërisë”.

2.4 Objekt i inspektimit është vlerësimi i efikasitetit në zbatimin e Memorandumit të Bashkëpunimit për organizimin e shërbimeve të përbashkëta të policimit rrugor të Policisë së Kosovës dhe Policisë së Shtetit Shqiptar në territorin e Republikës së Shqipërisë gjatë sezonës së verës në akset rrugore në Shqipëri.

2.5 Në kuadër të planifikimit të aktiviteteve nga Njësia Inspektuese (Departamenti i Inspektimeve të IPK-së dhe Drejtoria e Inspektimit dhe Ankesave të SHÇBA-së) janë përcaktuar këto objektiva:

- Vlerësimi i respektimit të Memorandumit Bashkëpunimit ndërmjet Policisë së Kosovës dhe Policisë së Shtetit-Shqipëri të datës 30.06.2016 “Për organizimin e shërbimeve të përbashkëta të policimit rrugor të Policisë së Kosovës dhe Policisë së Shtetit Shqiptar në territorin e Republikës së Shqipërisë”.
- Vlerësimi i performancës policore në hartimin e planeve të veprimit dhe rezultatet e patrullimeve të përbashkëta.
- Vlerësimi i të priturve të qytetarëve të cilët qarkullojnë përgjatë rrugës së kombit nga patrullimet e përbashkëta, përmes intervistave.

2.6 Të autorizuar të kryejnë inspektim të jashtëzakonshëm/paplanifikuar, IPK-ja dhe SHÇBA-ja ka angazhuar inspektorët, të cilët në vazhden e nxjerrjes së informacionit të duhur, kanë siguruar:

- dokumente të shkruara (raporte-analiza të punës, orare të patrullimeve, urdhëra operativ, urdhër shërbime, procesverbale)
- intervista me punonjës policorë të nivelit të lartë drejtues ose nivelit zbatues dhe qytetarë të ndryshëm si në vijim:
 - Drejtorin e Drejtorisë së Policisë Rrugore në PSH;
 - Drejtorin e Divizionit në Komunikacionin Rrugor të PK-së;
 - Shefat e Sektoreve të Policisë Rrugore;
 - Shefat e Seksioneve të Qarkullimit Rrugor;
 - Zyrtarë policor në kuadër të ekipeve Patrulluese;
- Intervista me qytetarë rasti gjatë qarkullimit në “Rrugen e Kombit”.

2.7 Inspektimi i jashtëzakonshëm/paplanifikuar i autorizuar nga Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së dhe Drejtori i Përgjithshëm i SHÇBA-së është bazuar në këtë kuadër ligjor:

- Ligji i Policisë së Republikës së Kosovës (2011/04-L-076);
- Ligji nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, Republika e Shqipërisë;
- Memorandumit Bashkëpunimit ndërmjet Policisë se Kosovës dhe Policisë se Shtetit-Shqipëri te datës 30.06.2016 “Për organizimin e shërbimeve te përbashkëta te policimit rrugor te Policisë se Kosovës dhe Policisë se Shtetit Shqiptar ne territorin e Republikës se Shqipërisë”.
- Urdhri Operativ i DPP-PK-së. “Zbatimi i Marrëveshjes se bashkëpunimit mes Policisë se Shtetit Shqiptar dhe Policisë se Republikës se Kosovës-2016” Nr. Ref;04/03/179/2016 data 28.06.2016.
- Urdhëri nr.645 të datës 01.07.2016 i DPSH-së. “Për Planifikimin , organizimin dhe kryerjen e shërbimeve të Policisë Rrugoretë përbashkëta ndërmjet Policisë së Kosovës dhe Shërbimeve të policisë rrugore të Shqipërisë për rritjen e sigurisë gjatë sezonit turistik 2016”.

2.8 Periudha e vlerësuar në këtë raport inspektimi përfshinë periudhën kohore Korrik-Gusht 2016.

2.9 Fushat e inspektimit :

- Organizimi dhe funksionimi i patrullimeve të përbashkëta,
- Efikasiteti,
- Evidentimi i problematikave dhe dhënia e rekomandimeve

2.10 Metodologjia :

- Kqyrja, administrimi dhe vlerësimi i dokumentacionit,
- Intervistime me punonjës të strukturës,
- Inspektime të ekipeve patrulluese në teren,
- Opinionet e qytetarëve shërbuj të rastit.

2.11 Për hartimin e këtij raporti është bërë analizimi i akteve ligjore përkatëse, respektivisht Memorandumit Bashkëpunimit ndërmjet Policisë se Kosovës dhe Policisë së Shtetit, Shqipëri të datës 30.06.2016 “Për organizimin e shërbimeve te përbashkëta te policimit rrugor te Policisë se Kosovës dhe Policisë se Shtetit Shqiptar ne territorin e Republikës se Shqipërisë”.

3. PËRMBAJTJE

3.1 Vlerësimi i detyrave për respektimin e Memorandumit të Bashkepunimit.

3.1.1 "Memorandumi i bashkëpunimit për organizimin e shërbimeve të përbashkëta të policimit rrugor të Policisë së Kosovës dhe Policisë së Shtetit Shqiptar në territorin e Republikës së Shqipërisë gjatë sezonës së verës", ka si qëllim rritjen e elementëve të sigurisë rrugore gjatë sezonit turistik Qershor-Shtator 2016. IPK në bashkëpunim me SHÇBA-në organizuan një Inspektim të Përbashkët, për mbikqyrjen e zbatimit të dispozitave në memorandum dhe inspektimin e strukturave policore në terren, me qëllim të rritjes së cilësisë së shërbimeve dhe efikasitetin e patrullimeve të përbashkëta në nivelin e kërkuar/pritura nga qytetarët.

3.1.2 Referuar kësaj marrëveshje të bashkëpunimit, mbi organizimin e shërbimeve të përbashkëta të policimit rrugor të policive të të dy shteteve, kërkohet një përqendrim i angazhimeve policore nga NJKA dhe NJKRR-të për organizimin e patrullimeve të përbashkëta për të parandaluar aksidente të mundshme, evidentimin e kundravajtjeve dhe respektimin e normave të sjelljes në rrugë nga përdoruesit e rrugës.

3.1.3 Me hyrjen në fuqi të Memorandumit të Bashkëpunimit Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës ka hartuar dhe ka nxjerrë Urdhri Operativ "Zbatimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit mes Policisë së Shtetit Shqiptar dhe Policisë së Republikës së Kosovës-2016".

3.1.4 Qëllim i këtij Urdhri Operativ është që të vendoset bashkëpunimi konkret gjatë kësaj periudhë dhe të ndërmerren masat e duhura policore në drejtim të parandalimit, zvogëlimit të numrit të aksidenteve në komunikacionin rrugor si dhe rritja e shkallës së sigurisë për të gjithë qytetarët edhe përdoruesit e rrugës, që qarkullojnë në akset rrugore që lidhin dy vendet duke e rregulluar dhe kontrolluar trafikun.

3.1.5 Bazuar në detyrat dhe përgjegjësitë që dalin nga Urdhri Operativ, NJKA dhe NJKRR-të, janë përgjegjëse për caktimin dhe udhëtimin e zyrtarëve policor në Republikën e Shqipërisë. Ndërsa detyrat konkrete bazohen në planet dhe veprimet e hartuara nga Policia Rrugore e Republikës së Shqipërisë të cilat do të zbatohen në akset rrugore në territorin Shqiptar, në bashkëpunim me patrullat e policisë rrugore.

3.1.6 Me Urdhri Operativ të PK-së, janë përcaktuar drejtoritë kompetente të cilat ngarkohen me detyrat dhe përgjegjësitë e zbatimit të tij. Po ashtu bartës i implementimit të këtij urdhri është ngarkuar Drejtori i Drejtorisë për Preventivë në Komunikacionin Rrugor dhe udhëheqesi i Njësisë për Kontrollin e Autostradës.

3.1.7 Nga ana tjetër pas nënshkrimit të Memorandumit të Mirëkuptimit, më qëllim të zbatimit të kësaj marrëveshje, Drejtoria e Policisë së Shtetit ka nxjerrë Urdhërin nr.645 të datës 01.07.2016. "Për Planifikimin, organizimin dhe kryerjen e shërbimeve të Policisë Rrugore të përbashkëta ndërmjet Policisë së Kosovës dhe Shërbimeve të policisë rrugore të Shqipërisë për rritjen e sigurisë gjatë sezonit turistik 2016".

3.1.8 Njëpërmjet këtij urdhri të cituar më lartë, DPSH urdhëron Drejtorinë vartëse të saj Drejtorinë e Përgjithshme për Siguri njëpërmjet Drejtorisë Rrugore që të marrin masat e

nevojshme për planifikim, organizim të kryerjes së shërbimeve të përbashkëta ndërmjet policive të të dyja vendeve. Poashtu nëpërmjet këtij urdhri në pajtim me dispozitat e Memorandumit (*nenin 4 paragrafi 1*) përcaktohet shpërndarja e punonjësve të policisë së Kosovës nëpër Seksionet e Menaxhimit të Trafikut Rrugor në Sektorin e Policisë Rrugore Lezhë 2 vetura të PK-së dhe 4 zyrtarë policorë si dhe një veturë e PK-së me 2 zyrtarë policor në Seksionin e Menaxhimit të Trafikut rrugor në Durrës. Në bazë të Urdhërit të DPSH-së zyrtarët policorë të Kosovës do të punojnë në orar prej 40 orësh në javë.

3.1.9 Me urdhrin e DPSH-së janë përcaktuar drejtoritë kompetente të cilat ngarkohen me detyrat dhe përgjegjësitë e zbatimit të tij. Poashtu janë përcaktuar edhe pozitat e larta menaxherale të cilat do të ngarkohen me kontrollin dhe zbatimin e këtij urdhri.

3.9.10 Në sajë të zbatimit dhe detyrave konkretë që dalin nga dispozitat e Memorandumit të Bashkëpunimit (*neni 5 paragrafi 2*), Ministri i Punëve të Brendshme i Republikës së Shqipërisë, me datë 11.07.2016 ka nxjerrë Urdhër me nr. 347, për akomodimin dhe trajtimin më ushqim të punonjësve të Policisë së Kosovës, në ambientët e Shtëpisë së Pushimit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Durrës.

3.1.11 Në zbatim të memorandumit të bashkëpunimit, neni 2, dhe Urdhrit Operativ, të gjitha NJKRRT-të dhe NJKA-të caktojnë nga dy (2) zyrtarë policor (gjithsej 6 zyrtar), me tre (3) automjete zyrtare që do të punojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë për 10 ditë pune sipas orarit të përcaktuar me urdhër operativ/planizimit të shërbimit. Personi përgjegjës për koordinimin e zyrtareve të Policisë së Kosovës është përcaktuar një punonjës me gradën rreshter, i cili në përfundim të afatit dhjetë ditor përpilon dhe raportin përmbledhës të aktivitetit policor në Republikën e Shqipërisë.

3.1.12 Përzgjedhjen e zyrtareve policore të cilët do të angazhohen në implementimin e Memorandumit bëhet nga ana, e udhëheqëseve të NJKRRT-ve dhe NJKA duke aplikuar kriteret për policët me të dalluar dhe kanë treguar integritet të lartë në shërbim.

3.1.13 Policët e planëzuar/përcaktuar, kompletojnë dokumentacionin relevant (për udhëtime zyrtare jashtë vendit) sipas rregulloreve. Para nisjes, ekipi policor i PK-së, mbajnë takime njoftuese me menaxhmentin kompetent të Policisë së Kosovës për marrjen e instruksioneve për detyrat dhe kompetencat e njësive policore Kosovare që dalin nga Memorandumi i Bashkëpunimit.

3.1.14 Qëndrimi, akomodimi për zyrtarët policor të PK-së është siguruar në qytetin e Durrësit. Nga vendi i akomodimit ekipet e PK-së, nisen drejtë seksioneve të menaxhimit rrugor/Stacioneve policore ku janë të planëzuar/përcaktuar në detyra policore. Gjatë bisedës me zyrtarët policor ata janë shprehur se nuk kanë vërejtje lidhur me kushtet e akomodimit dhe ushqimit të ofruar nga Ministria e Punëve të Brendshme e Shqipërisë.

3.1.15 Zyrtarët policor të Policisë së Kosovës janë të pajisura me pajisje personale të rregullta, uniformë, armë brezi, pranga, sprej, jelekë reflektuese dhe stopa dore. Veturat zyrtare janë të kompletuar me pajisjet percjellëse për patrullim. Për ndryshim nga vitet e kaluara, këtë vit njësitët policore të PK-së, nuk janë të pajisura me radar për matjen e shpejtësisë së levizjes së automjeteve dhe alkolteste.

3.2. Vlerësimi i performances policore dhe rezultatet e patrullimeve të përbashkëta

3.2.1 Patrullat e përbashkëta të të dy policive në përputhje më marrëveshjen e bashkëpunimit aplikojnë kontrole dhe vëzhgim të mbarëvajtjes së qarkullimit rrugor duke qëndruar nëpër pika statike, në vende këto të identifikuar si **“njolla të zeza”**.

3.2.2 Orari i angazhimit të njërive policore të Kosovës aplikohet në dy turne/ndërrime. Ndërrimi i paradite, kur ka fluks të hyrjes së qytetareve në Republikën e Shqipërisë dhe ai i pasdites kur ka fluks në dalje nga territori shqiptar në drejtim të territorit të Kosovës. Turni/ndërrimi paradite aplikohet nga ora 06⁰⁰-14⁰⁰ për 5 ditë (e hënë- e ejte dhe të shtunën). Ndërsa turni/ndërrimi i dytë aplikohet nga ora 14⁰⁰-22⁰⁰ gjatë të premtave dhe të dielave për shkak të fluksit të largimit të udhëtarëve nga Republika e Shqipërisë në drejtim të Kosovës.

3.2.3 Patrullimin në rrugë zyrtarët policor të PK-së e bëjnë në kuadër të ekipeve të përbashkët më oficerët policor të PSH-së. Nga inspektimi i patrullave në terren u konstatua se patrullimi kryhej në kombinim, një (1) zyrtarë i policisë rrugore i PSH dhe një (1) zyrtarë policorë nga PK duke shënuar numrin në 6 patrulla të përbashkëta.

3.2.4 Zonat në të cilat janë të planëzuara/planifikuara shërbimet e qarkullimit rrugor janë të planëzuara 6 patrullat e përbashkëta. Në segmentin e Tunelit të Kalimashit- Milot (2 patrulla), Milot-Lezhë (2 patrulla) dhe Maminas-Durrës (2 patrulla).

- Sipas ndarjes gjeografike Qarku/Regjioni Lezhës ka 3 akse rrugore kryesore me gjatësi 106.3 km, të cilat janë aksi Milot-Thirrë 68 km, Milot-Lezhë 18.4 km dhe Milot-Thumanë 19.9 km, e cila monitorohet me 4 patrulla të përbashkëta.
- Sipas ndarjes gjeografike Qarku/Regjioni Durrës, aksin kryesor të qarkullimit e ka në rrugën Tiranë-Durrës e cila monitorohet/patrullohet me 2 patrulla të përbashkëta me gjatësi 18 km.

3.2.5 Gjatë inspektimit të përbashkët në teren nga ekipi i inspektimit janë inspektuar 5 ekipe patrulluese policore më përberje të kombinuar për patrullim të përbashkët. Këto patrulla janë hasur nëpër vendet/lokacionet e planëzuara për patrullim brenda orarit ditor të punës.

3.2.6 Planizimi/planifikimi i shërbimeve të përbashkëta të qarkullimit rrugor kryesisht vendosen në pika të identifikuar si **“njolla të zeza”** nga Drejtoria e Policisë Rrugore Shqiptare, për shkak së në këto akse rrugore ndodhin aksidente Rrugore/Komunikacioni me pasoja të rënda në njerëz si dhe dëme materiale. Poashtu disa patrulla gjatë orarit ditor të punës vendosen nëpër kryqëzime/udhëkryqe ku ka frekuentim dhe ngarkesë të madhe të fluksit të qarkullimit rrugor duke u inkuadruar në drejtimin dhe rregullimin e rrjedhes së qarkullimit rrugor më qellim të shmangies së aksidenteve të komunikacionit dhe eliminimit të kolonave/ngecjeve të gjata në trafik.

3.2.7 Koordinimi dhe bashkëpunimi i ekipeve të patrullimit të përbashkët nëpër akset rrugore funksionon mjaft mirë, ku ndaljen dhe patrullimin e Qarkullimit/Komunikacionit rrugor e bëjnë bashkarisht oficerët e të dy policive. Zyrtarët policor të PK-së, kur identifikojnë kundravajtësit e trafikut, atyre ju komunikojnë verbalisht arsyen e ndaljes dhe bëjnë kontrollin e

dokumentacionit ndërsa shqiptimin e masave administrative bëhet nga oficerët policorë të policisë rrugore sipas Memorandumit. Zyrtarët policorë të PK-së nuk kanë mandat ekzekutiv gjatë realizimit të patrullimit të përbashkët në territorin shqiptar, siç është e parashikuar edhe në memorandum.

3.2.8 Patrullave policore në terren nga ekipi i inspektimit, vëmendje i është kushtuar trajtimit dhe shqiptimit të masave administrative/gjobave. Është konstatuar se nga ekipet e patrullimeve të përbashkëta brenda një orari ditor shqiptohen diku mesatarisht 10 deri 20 masa administrative/gjoha ndaj shkelësve të rregullave të qarkullimit rrugor. Arsyet e masave/gjobave të shqiptuara në kohën e inspektimit ishin kryesisht shkeljet e rregullave të qarkullimit rrugor për parakalim të ndaluar, mosvënje e rripit të sigurisë, dhe përdorim e celularit gjatë ngasjes. Asnjë masë /gjobë e shqiptuar nuk ka qenë për mosrespektim të shpejtësisë së kufizuar ngase asnjë nga patrullat policore të inspektuara nuk kanë qenë të pajisura me radar laserik për matjen e shpejtësisë.

3.2.9 Në përfundim të qëndrimit 10 ditor në territorin e Republikës së Shqipërisë përpilohet një raport i shkurtër, nga zyrtarët e PK-së, i cili i dorëzohet rreshterit. Më pas rreshteri harton raportin përmbledhës të cilin ja dorëzon Drejtorit për Preventiv në Komunikacionin Rrugor në Drejtori të Përgjithshme të PK-së, i cili në përfundim të sezonit përgatitë raportin përmbledhës për ecurinë e bashkëpunimit si dhe një analizë pasoperacionale.

3.2.10 Gjatë inspektimit në kuadër të strukturave të Drejtorisë së Policisë Rrugore të PSH-së, nuk kemi siguruar se në kuadër të tyre hartohet ndonje raport i shkruar lidhur me ecurinë e aktiviteteve të patrullimeve të përbashkëta të të dyja policive pas çdo turni/ndrrimi 10 ditor. Drejtuesit e kësaj strukture kishin deklaruar se raportin e vetëm përmbledhës për tërë ecurinë dhe rezultatet punës së përbashkët të zbatimit të memorandumit të bashkëpunimit hartohet pas përfundimit të gjithë aktivitetit (në përfundim të sezonës).

3.3. Vlerësimi i të priturve të qytetarëve të cilët qarkullojnë përgjatë “Rrugës së Kombit”.

3.3.1 Rendi dhe siguria publike është njëra nga parakushtet për lirinë e lëvizjes, qarkullimin e lirë të njerëzve mallrave dhe shërbimeve si dhe forcimin e bashkëpunimit me qytetarë. Një rëndësi të madhe Policia e Shtetit Shqiptarë dhe Policia e Kosovës, do t'i kushtojë edhe ngritjes së shkallës së besimit publik në raport me komunitetin, po ashtu theks i veçantë do t'i kushtohet bashkëpunimit me qytetarë në parandalimin/zvogëlimin e aksidenteve të komunikacionit, me qasje pro-aktive/parandaluese të identifikimit, analizimit dhe zgjidhjes së problemit.

3.3.2 Gjatë inspektimit të përbashkët në terren nga e ekipi i inspektimit, në funksion të vlerësimit të të priturve të qytetarëve, janë intervistuar shtetas të ndryshëm dhe përdorues të rrugës të cilët kanë lëvizur nga Kosova për në Shqipëri.

3.3.3 Qytetarët (responentet) e intervistuar nga ekipi i inspektimit, shprehin opinionin e tyre lidhur me organizimin e patrullimit të përbashkët të policive të të dyja vendeve dhe e kanë mirëpritur një veprim të tillë. Ata u shprehën se janë të kënaqur dhe e përkrahin prezencën e njëjësive policore të përbashkëta të dy vendeve nëpër akset rrugore ku ka një fluks të lartë, me qytetar kosovar të cilët hynë në territorin e Shqipërisë dhe anasjelltas.

3.3.4 Qytetarët e anketuar/intervistuar shprehin opinionet se prezenca fizike e zyrtarëve policorë të PK-së nëpër akset rrugore të Republikës së Shqipërisë ngrit ndjenjën e sigurisë dhe besimit të ndërsjellët.

3.3.5 Referuar intervistave me zyrtarët policor kompetent sikur ata nga Policia e Shtetit Shqiptar ashtu edhe ata nga Policia e Kosovës të cilët janë pjesë aktive e implementimit të marrëveshjes së bashkëpunimit, pohojnë së janë të kënaqur me trajtimin dhe pranueshmerinë e qytetareve që frekuntojnë akset rrugore gjatë të cilave zhvillohen aktivitete të përbashkëta patrulluese. Ata deklarojnë së që nga fillimi i sezonit nuk kanë pasur/pranuar asnjë ankesë qoftë verbale apo më shkrim nga qytetaret ndaj zyrtarëve policor të të dyja vendeve.

4. PËRFUNDIMET

4.1 Me hyrjen në fuqi të Memorandumit të Bashkëpunimit, të dy Drejtoritë si Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës dhe Drejtoria e Policisë së Shtetit kanë ndermarrë veprimet konkrete përgaditore planifikuese lidhur me zbatimin e marrëveshjes në mes të dyja vendeve. Në njërën anë Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës ka nxjerrë Urdhërin Operativ "Zbatimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit mes Policisë së Shtetit Shqiptar dhe Policisë së Republikës së Kosovës-2016". Ndërsa në anën tjetër, Drejtoria e Policisë së Shtetit ka nxjerrë Urdhërin nr.645 të datës 01.07.2016. "Për Planifikimin, organizimin dhe kryerjen e shërbimeve të Policisë Rrugore të përbashkëta ndërmjet Policisë së Kosovës dhe Shërbimeve të policisë rrugore të Shqipërisë për rritjen e sigurisë gjatë sezonit turistik 2016". Pra është plotësuar kuadri ligjor me aktet e nevojshme për zbatim të Memorandumit.

4.2 Në memorandumimin e bashkëpunimit është parashikuar një numër prej 6 (gjashtë) punonjësish dhe 3 (tre) mjetesh, të cilat operojnë vetëm në një turn/ndërrim. Nga struktura inspektuese vlerësohet se numri i burimeve njerëzore është i pamjaftueshëm për të mbuluar nevojat gjatë sezonit turistik, pasi konstatohet se fluksi i qarkullimit të mjeteve është i vazhdueshëm çdo ditë, gjatë orarit 08⁰⁰-23⁰⁰.

4.3 Patrullat e përbashkëta të cilat operojnë në Qarkun/Regjionin e Lezhës janë të akomoduar në qytetin e Durrësit, distancë e cila është rreth 100 km, e cila ndikon në mënyrë të drejtëpërdrejtë në kosto/shpenzime udhëtimi, lodhje dhe nganjëherë vonesa kohe për paraqitjen në shërbim të punonjësve të PK-së.

4.4 Punonjësit e njësisë policore të PK-së kanë ardhur të pa pajisura me paisjet shtesë siç janë radari dhe alkoltesti. Drejtori i Drejtorisë për Preventivë në Komunikacionin Rrugor, për këtë problematikë, u shpreh se këto pajisje nuk janë dhënë njësisë policore të PK-së pasi nuk janë të kalibruara nga institucioni përgjegjës të Republikës së Shqipërisë dhe pa një proces të tillë, organi administrative shtetëror ose Gjykata Administrative nuk i njeh fuqinë e provës gjatë procedimit administrativ dhe gjyqsor.

4.5. Mos pajisja apo mungesa e radareve laserik për ekipet e patrullimeve të përbashkëta ka pasur për pasojë mosmundesinë e ndëshkimit të ngasësëve të cilët shkelin rregullat e kufizimit të shpejtësisë së lejuar. Kjo gjendje ndikon drejtëpërdrejt në cënimin e gjendjes së sigurisë në qarkullimin rrugor, kur dihet se mosrespektimi i shpejtësisë së lejuar nga ngasësit, më së shpeshti është njeri ndër shkaktarët kryesor të aksidenteve në komunikacion.

4.6 Gjatë inspektimit rezultoi se Sektorët e Qarkullimit Rrugorë në Drejtoritë Vendore Durrës dhe Lezhë nuk kishin hartuar apo administruar raporte përmbledhëse për aktivitete dhe rezultatet mbi ecurinë e njësisë të patrullimeve të përbashkëta të cilat funksionojnë gjatë turnit/ndërrimit 10 ditor.

4.7 Në aksin Durrës-Vlorë, u konstatua se kishte qarkullim të mjeteve dhe shtetasve nga Republika e Kosovës, aks kryesor i Republikës së Shqipërisë, i cili nuk moniturohet/patullohet nga ana e njësisë të patrullimeve të përbashkëta.

4.8 Konstatohet se nga qytetarët e intervistuar, ka perceptim shumë pozitiv për prezencën e njësive policore të përbashkëta të dy vendeve, duke rritur ndjeshëm ndjenjën e sigurisë dhe besimit të ndërsjellë. Më opinionin tyre shprehin perceptim pozitiv për këtë bashkëpunim në mes të dy vendeve njëherit shprehin dëshirën e tyre që i njëjti të vazhdojë edhe në vitet e ardhshme.

5. REKOMANDIMET

Në drejtim të përmirësimit dhe ngritjes së vazhdueshme të performancës së personelit policor, IPK-SHÇBA nxjerrin këto rekomandime kryesore:

- 5.1 *IPK-SHÇBA rekomandon për memorandumun pasardhës strukturave përkatëse në Policinë e Kosovës dhe Drejtorisë së Policisë së Shtetit në Shqipëri, për shtimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe pajisjeve/materialeve nga Policia e Kosovës.*
- 5.2 *IPK-SHÇBA rekomandon për memorandumun pasardhës që Policia e Kosovës dhe Drejtoria e Policisë së Shtetit në Shqipëri të angazhohen për gjetjen e zgjidhjeve ligjore për njohje dhe vlefshmërinë e kalibrimit për pajisjet e matjes së shpejtësisë (radarëve) dhe alkol-testeve nga institucioni përgjegjës i Republikës së Shqipërisë me qëllim vënien në punë të tyre dhe përdorimin pa pasur pengesa ligjore, gjë që do të çonte në parandalimin e aksidenteve rrugore dhe dokumentimin e shkeljeve.*
- 5.3 *IPK-SHÇBA rekomandon për memorandumun pasardhës përfshirjen e aksit Durrës-Vlorë për organizimin e shërbimeve të përbashkëta të patrullimit, pasi është një aks që frekuentohet shumë nga pushuesit kosovar dhe se do të ndikonte për krijimin një ambienti më të sigurt për të gjithë qytetarët në këtë aks.*
- 5.4 *IPK-SHÇBA rekomandon për memorandumet pasardhëse, drejtuesve të Policisë së Shtetit dhe Policisë së Kosovës që punonjësit e Policisë së Kosovës të planizuara/caktuar për shërbim në Drejtorinë Vendore t'ju sigurohet akomodimi sa më pranë zonave ku janë caktuar në shërbim me qëllim shmangien e kostove dhe rritjen e efikasitetit.*
- 5.5 *IPK-SHÇBA rekomandon shëfave të seksioneve të qarkullimit/komunikacionit rrugor në Drejtorinë Vendore në Durrës dhe Lezhë të hartojnë dhe administrojnë raporte përmbledhëse për punonjësit e njësisë së patrullimeve të përbashkëta, të cilat ndërrohen në intervalet 10-ditore.*